

100 DITË

Ministria e Zhvillimit Rajonal



Në kuadër të detyrave dhe përgjegjesive të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal gjatë punës 100 ditore mars-qershor 2021 në pika të shkurtra do të prezantojmë të arriturat e MZHR-së për këtë periudhë ashtu siç janë paraqitur edhe në raportin 100 ditorë:

Hartimi dhe koordinimi i politikave

- MZHR, ka përgatitur dhe proceduar në Sekretariatit Koordinues të Qeverisë pjesën e saj të Planit të Punës së Qeverisë për vitin 2021-25 brenda afateve të përcaktuara, si dhe ka përgatitur Planin e brendshëm të Punës së Ministrisë për vitin 2021 dhe të njëjtin e ka publikuar në uebfaqe të MZHR-së.
- MZHR ka realizuar pesë punëtori me kryetarët e komunave shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit në pesë rajonet zhvillimore për promovimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal 2020 – 2030 në muajin maj-qershor 2021.
- Është finalizuar dokumenti “Analiza e investimeve kapitale të Ministrive të linjës të realizuara sipas rajoneve zhvillimore për vitin 2020” e cila analizë gjithashtu do të trajtoj të dhënat krahasimore për tre vite 2018-2020.

100 DITË

Ministria e Zhvillimit Rajonal



Hartimi dhe koordinimi i politikave

- MZHR në muajin qershor 2021, ka themeluar grupin punues për hartimin e Ligjit për Zhvillim Rajonal dhe ka përgaditur draftin fillestar;
- Lidhur me Zhvillimin e sistemit për menaxhimin e performancës rajonale, MZHR ka finalizuar termat e referencës për studimin e fizibilitetit dhe disajnimin e sistemit për monitorimin e zhvillimit socio - ekonomik rajonal të balancuar.
- MZHR, në bashkëpunim me institucionet tjera ka mbajtur takimin e grupit punues për zhvillimin dhe definimin e kriterëve të brendeve rajonale, takimi është bajtur në muajin prill 2021.
- MZHR ka përgatitur PyetëSORIN Vetë-vlerësues për Menaxhimin Financiar dhe të Kontrollit 2020 dhe Listën e rreziqeve për vitin 2021.

100 DITË

Ministria e Zhvillimit Rajonal



Kursimet buxhetore

- Vlen të theksohet se në kuadër të rishikimit buxhetor MZHR ka dekraluar kursime në vlerë prej 60,000.00 €;
- Së fundmi kemi gjetur zgjidhje për kursimin e mjeteve, ku do të kursejm afro 100,000.00 euro në vit duke kaluar nga objekti me qera në pronë publike nga 01 Shator 2021.

100 DITË

Ministria e Zhvillimit Rajonal



Përkrahja financiare e Komunave

➤ MZHR në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal (kategoria e investimeve kapitale) për vitin 2021, ka ndarë mjetet për shtatëmbëdhjetë (17) projekte për financimin e investimeve kapitale në 16 komuna dhe janë zotuar mjetet nga MZHR në vlerë prej 965,000 €.

Përkrahja financiare e Bizneseve dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës

➤ MZHR ka përgatitur dhe lansuar skemën e granteve Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar si dhe Programin për Rimëkëmbje Ekonomike Masa 15 (Përkrahja e bizneseve 2021) ku aplikimi është bërë në formë elektronike përmes sistemit EKOSOVA. Procesi i vlerësimit të bizneseve është finalizuar si dhe MZHR ka bërë përzgjedhjen e 154 përfituesve dhe nënshkrimin e kontratave, nga kjo skemë planifikohet të gjenerohen 349 vende të reja punës.

Përkrahja financiare e OJQ-ve

➤ Ministria e Zhvillimit Rajonal përmes Thirrjes Publike që realizon çdo vit për mbështetjen financiare të projekteve/programeve të QJQ-ve për avancimin e zhvillimit socio ekonomik rajonal të balancuar ka mbështetur Organizata Joqeveritare si dhe një numër të konsiderueshëm të udhëhequra nga gratë ku në total janë financuar tridhjetë e dy (32) OJQ në vlerë totale prej 100,000.00 euro.

100 DITË

Ministria e Zhvillimit Rajonal



Bashkëpunimi me Partnerët ndërkombëtarë

Gjatë kësaj periudhe, kemi zhvilluar një mori takimesh me partnerët ndërkombëtarë, dhe kemi shkëmbyer letra zyrtare për vendosjen e bashkëpunimit për realizimin e aktiviteteve dhe programeve në fushën e zhvillimit socio-ekonomik rajonal si në vijim:

- Takim me Ambasadën Amerikane për mundësitë e bashkëpunimit në mes MZHR dhe programeve të USAID-it në Kosovë.
- Takim me Ambasadën Gjermane, ku është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit mes MZHR-GIZ.
- Takim me Organizatën CARITAS, ku është inicuar marrëveshja e bashkëpunimit për dy projekte të përbashkëta në funksion të zhvillimit socio ekonomik rajonal të Kosovës. Si rrjedhojë e takimit është finalizuar draft marrëveshja e bashkëpunimit.

100 DITË

Ministria e Zhvillimit Rajonal



Bashkëpunimi me Partnerët ndërkombëtarë

- Takim me Ambasadën Turke, ku u diskutua për mundësitë e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e zhvillimit rajonal.
- Takim me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë, ku është rikonfirmuar vazhdimi i bashkëpunimit edhe në projekte tjera të përbashkëta. Është iniciuar bashkëpunimi në hartimin e dokumentit analitik të përbashkët për praktikant, si dhe është bërë lansimi i thirrjes publike për Praktikant si iniciativë e përbashkët MZHR-UNICEF.
- Takim me zyrën koordinuese të programit TIKA në Prishtinë ku është dakorduar mbi planin e veprimit në funksion të bashkëpunimit të ndërsjellët

100 DITË

Ministria e Zhvillimit Rajonal



Bashkëpunimi me Partnerët ndërkombëtarë

- Gjatë muajit Qershor është realizuar takimi bilateral me Ministrin e Industrisë dhe Teknologjisë të Turqisë z. Mustafa Varank i cili është përgjegjës edhe për Zhvillimin Rajonal. Në takim është diskutuar bashkëpunimi i mundshëm në mes të dy ministrive dhe të ekspertëve me qëllim të shkëmbimit të përvojave. Gjithashtu është diskutuar bashkëpunimi për projekte të ndryshme, veqanërisht për projekte IPA.

Gjithashtu kujdes ju kushtua edhe akterëve tjerë të cilët mbështeten nga programet e MZHR-së si Komuna dhe biznese ku janë realizuar gjithashtu disa vizita në Komunat si: Shtime, Prizren, Vushtri, Mitrovicë Jugore etj, Agjensionet e Zhvillimit Rajonal (AZHR-të), si dhe bizneset përfituese nga MZHR.